



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:119716

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610644

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Idrizi, në çështjen penale ndaj të pandehurit Z.R. me vendbanim në fshatin ... në Ferizaj, për shkak të veprës penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.862/2021 të datës 21.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, më datë 15.03.2024, në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit Sadat Topalli prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri Z.R. me mbrojtësin e tij me autorizim av. Liman Musa dhe përfaqësuesja e Doganës së Kosovës A.H.D., më datë 18.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 23.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Z.R., nga i ati S. e ëma E. e gjinisë Q., i lindur më ..., në fshatin ... komuna Ferizaj, me vendbanim po në të njëjtin vend, me vendqëndrim të përkohshëm në Gjermani, me numër personal ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesionin tregtar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Në kohë të pa caktuar e gjer me datë 05.06.2021 në fshatin ..., Komuna Ferizaj saktësisht në një shteg të improvizuar dhe të rrethuar përkohësisht me qëndrim të lirë, i pandehuri duke kaluar vijën kufitare Republikë e Maqedonisë Veriore - Republikë të Kosovës përmes rrugëve malore bartë mallra - gjedhe të gjalla dhe shmang kontrollin doganor, në atë mënyrë që i pandehuri nga fshati ..., Republika e Maqedonisë Veriore, përmes rrugëve malore ka bartë tridhjetë e pesë (35) copë gjedhe të gjalla prej të cilave trembëdhjetë (13) prej tyre kishin nga një numër identifikues vetëm në njërin veshë e që nuk përputhën me të dhënat në sistemin e AUV-it, ndërsa njëzet e dy (22) tjera pa pasur fare dokumentacion dhe në mungesë të verifikimit të origjinës së tyre të gjitha gjedhet sekuestrohen nga Policia e Kosovës.

-Me këtë ka kryer veprën penale **Kontrabandimi i mallrave** nga neni 311 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4 , 7, 8, 17, 21, 38, 43, 69, 70, dhe 311 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

G J Y K O N

- I. Dënim me gjobë në shumën prej 2,000 (dymijë) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë 4 (katër) këste të barabarta në vlerë prej 500 (pesëqind) euro brenda afatit prej 4 (katër) muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.
- III. Konfiskohen në mënyrë të përhershme 35 (tridhjetë e pesë) copë gjedhe dhe atë 32 (tridhjetë e dy) krerë lopë dhe 3 (tre) krerë viça.
- IV. Dogana e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- V. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.862/2021 të datës 21.06.2021, ndaj të akuzuarit Z.R., me vendbanim në me fshatin ... Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të KPRK-së.

Më datë 03.11.2022, 21.03.2023, 14.12.2023, 27.04.2023, 16.10.2023, 20.12.2023 dhe 15.03.2024 janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor ku kane prezantuar prokurori i shtetit Sadat Topalli, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri Z.R. me mbrojtësin e tij me autorizim av. Liman Musa dhe përfaqësuesja e autorizuar e Doganës së Kosovës në cilësi të dëmtuarës A.H.D..

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj, për shkak se me datë kohë dhe vend të përshkruar si në aktakuzë është vërtetuar gjendja faktike, konform dispozitave ligjore të nenit 351 të KPP-së paraqes fjalën përfundimtare, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik kundër të akuzuarit Z.R., kur pas administrimit të provave personale dhe materiale është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë si koha, data dhe vendi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar dëshmitarët si B.K., L.R., S.S., K.R., B.A., B.U. te cilët në mënyrë të saktë kanë dëshmuar faktin se 35 copë lopë të cilat janë konfiskuar kanë qenë të pa regjistruara në data bazën e AVUK-ut dhe nuk kane pasur matrikula ku 13 prej tyre edhe pse kishin matrikula të njëjtat nuk janë përputhur me të dhënat të cilat kanë qenë të regjistruara në regjistrat e AVUK-ut, ndërsa pas elaborimit të provave materiale siç janë të përshkruara në aktakuzë është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale në të cilën është ngritur edhe akti akuzues, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penale të paraparë me ligj, sa i përket rrethanave lidhur me llojin dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të merr për bazë rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë si dhe pasojën e shkaktuar nga kjo veprë penale, konform nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata të merr për bazë shkallën e lartë të dashjes duke marr parasysh nenin 70 par.2 pika 2.2, ndërsa rrethana lehtësuese prokuroria nuk ka gjetur, andaj i propozoj gjykatës të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal

të paraparë me ligj. Gjithashtu në bazë të nenin 115 par.2 dhe nenin 311 par 6 i KPRK-se i propozoj gjykatës që të bëjë konfiskimin e 35 copë gjedhi në mënyrë të përhershme.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës Dogana e Kosovës në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, kërkon që të konfiskohet gjedhët që janë objekt i veprës penale, dhe që të obligohet i pandehuri që të bëjë pagesën e detyrueshme të doganës në vlerë sipas mendimit të sektorit të vlerës.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se: në këtë fazë të procedurës konform ligjit në fuqi e japim fjalën përfundimtare në çështjen penale ndaj të mbrojturit tim ndaj të cilit është ngritur aktakuza për të cilën jemi të mendimit se gjatë seancave gjyqësore është vërtetuar e kundërta e asaj që është përshkruar në aktakuze duke filluar nga dëshmitarët të cilët e kanë elaboruar çështjen në tërësi si dhe bazën juridike ku një ndër ta e shpjegon se në bazë të ligjeve në fuqi në baze të rregullave të përgjithshme gjenerale sa i përket matrikulimit ekziston një rregull e cila deri në 20 % e dëmtimeve është e lejueshme kjo e vërteton edhe pretendimin tonë se kafshët kanë qenë të rrethuara me një vend jo adekuat pasi është improvizuar një rrethoj tek vendi i quajtur “K.G.” i cili gjendet skaj rrugës magjistrale Ferizaj – Kaçanik, konkretisht përball “M.” që është një qendër e rekreacionit dhe grafitimi i njerëzve është një numër të jashtëzakonshëm, këto kafshë kanë mund ti dëmtojnë matrikulat në rrethojat që kanë qenë nga teli. Mendojmë se asnjë nga elementet e figurës së veprës penale nuk është përmbushur, siç është koha, mënyra vendi, andaj i propozojmë gjykatës që mos të ja fal besimin aktakuzës së parashtruar nga ana e prokurorisë për shkak se në rastin konkret kemi të bëjmë me një person i cili brez pas brezi mirret me kultivimin e kafshëve, ku i njëjti këtë veprimtari e zhvillon me shumë si hobi dhe tradita familjare, pasi që i njëjti jeton dhe vepron në shtetin e Gjermanisë, mirëpo dëshira për kafshë dhe tradita familjare e ka shtyrë që i njëjti të bëjë një investim në vendlindjen e vet, që do të thotë një qumështore, një fabrikë për kultivimin e qumështit dhe për këtë arsye ka filluar me grumbullimin e lopëve qumështore, brenda territorit të Kosovës, brenda tregjeve të brendshme ku i kemi deklaruar edhe personat të cilët i kanë shitur këto bagëti, andaj edhe një herë e lusim gjykatën që ti trajtoj provat një nga një dhe të vie në përfundim të një vendimi meritor ku vlen të ceket në këtë rast vlen parimi in dubio pro reo dhe që të mbrojturin tim ta liroj nga akuza, pasi që në këtë rast është palë e dëmtuar i cili ka pësuar me konfiskimin e bagëtive ku ja ka pa mundësuar vazhdimin e krijimit të qumështores pasi ka humbur sigurinë juridike që në vendlindjen e tij të krijoj një qumështore.

2.1 Deklarata e dëshmitarit B.K.: unë punoj si hetues në njësinë e hetimeve rajonale të Policisë Kufitare dhe te ky rast kam dhënë dëshmi në prokurori si dhe jam përpilues i kallëzimit penal për këtë rast. Me datë 04.06.2021, rreth orës 12:45 kemi pranuar një informatë nga SPMK H.E., ku ata janë njoftuar nga njësitë i hetimeve rajonale në Ferizaj, se në fshatin ..., përball restorant “M.” në fushë të hapur të improvizuar me rrethoja gjendet një grup i madh i kafshëve – lopëve, këta dyshojnë se janë të kontrabanduara nga fshati ... i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njësitë i hetimeve rajonale të Kaçanikut, unë së bashku me kolegun tim V.T., kemi shkuar në vendin e ngjarjes rreth orës 13:30, aty prezent kishin qenë njësitë e hetimit të shpejtë, njësitë e hetimeve rajonale të Ferizaj, Dogana e Kosovës dhe inspektori i AUV – S.S., aty ka qenë prezent edhe i dyshuari Z.R. pronari i këtyre kafshëve i cili fillimisht ishte pyetur se a posedon dokumentacion lidhur me posedimin e këtyre kafshëve, i njëjti ka deklaruar se nuk ka kurrfarë dokumentacioni, verifikimi i kafshëve është bërë nga inspektori i AUV, përmes sistemit online, kanë qene prezent përafërsisht rreth 80 kafshë, 12 nga ato kafshë nuk janë përputhur me gjaninë, moshën apo racën sipas sistemit të AUV-it, ndërsa 17 të tjera nuk kanë pasur matrikula fare, 3 prej kafshëve të imta – vogla janë konfiskuar me insistimin e pronarit pasi kanë qenë të voglit e kafshëve të konfiskuar më lartë. Pasi që atë ditë pra me datë 04 qershor 2021, ka zgjatur verifikimi tërë ditën dhe nuk kemi mundur ti përfundojmë, kemi vazhduar edhe ditën e nesërme me mëngjes pra me datën 05 qershor, të nesërmen dy prej kafshëve nuk kanë pasur matrikula fare, ndërsa njëra nga ato nuk është përputhur sipas gjinisë, moshës apo racës sipas sistemit të AUV-it. Pra ditën e dytë janë sekuestruar tri kafshë. Pas sekuestrimit e kemi intervistuar të dyshuarin i cili ka deklaruar se nuk ka dokumentacion përkatës për këto kafshë. Me datë 01.06.2021 është pranuar një informatë në drejtorin rajonale të hetimeve në Kaçanik se i dyshuari Z.R. ka sjell një grup të madh të kafshëve dhe atë rreth 200 nga fshati Tanush e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet rrugëve ilegale në Republikën e Kosovës. Ju njoftoj se pas sekuestrimit të këtyre kafshëve për dy ditë radhazi nga Dogana e Kosovës këto kafshë janë dërguar në Burgun e Dubravës, pasi që kafshët që sekuestrohen dërgohen në atë burg. Pastaj ne kemi pranuar raportin nga AUV-i prejardhjen e këtyre kafshëve, pra kanë qenë 35, ndërsa pas tyre kemi pranuar edhe një raport nga Burgu i Dubravës në të cilin raport është konstatuar se 12 nga këto kafshë edhe pse kanë pasur matrikulen nuk janë përputhur me moshën, gjininë ose racën, ndërsa 17 të tjera nuk kanë pasur matrikula dhe nuk dihet origjina e tyre pasi që nuk janë të regjistruara, ndërsa këto kafshë të lartë cekura kanë të bëjnë me sekuestrimin e datës 04.06.2021, ndërsa për tri kafshë të sekuestruara me datë 05.06.2021, në raport është konstatuar se dy prej tyre nuk ka pasur fare matrikula, ndërsa njëra

prej tyre nuk përputhet me racën, gjininë apo moshën dhe në bazë të këtyre dy raporteve unë e kam përpiluar kallëzimin penal.

2.2 Deklarata e dëshmitarit L.R.: me datë 04.06.2021 është kërkuar nga ana e Policisë së Kosovës përkatësisht nga Stacioni Policor në Ferizaj që të bëhet inspektimi i disa gjedheve të cilat janë të vendosura në zonën e ish aeroportit bujqësor- KFOR-i grek në G., arsyeja ka qenë sepse ka pasur dyshim se janë të kontrabanduara, në momentin e inspektimit nga ana jonë në vendin ku kanë qenë të vendosura gjedhet të rrethuara në një zonë të caktuara ishin prezent rreth 80 krerë gjedhe, duke qenë se arsyeja e kontrollit ka qenë me urdhër të prokurorisë dhe policisë atëherë në koordinim me kryeprokurorin Shukri Jashari është kërkuar që të bëhet kontrollimi i gjendjes shëndetësore të tyre dhe verifikimi i origjinës së tyre sipas mandatit të A.U.V, duke qenë se A.U.V është autoritet që merret me gjendjen shëndetësore të kafshëve dhe posedon bazën e të dhënave për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve brenda territorit të Republikës së Kosovës, i është bërë kontrollimi i kafshëve prezent. Gjatë kontrollit apo verifikimit të gjedheve të moshave të ndryshme sepse nga ana e prokurorit është kërkuar nga unë që të jepet një koment për çështjen e matrikulimit të kafshëve dhe periudhën se kur duhet të kryhet ky shërbim tek fermerët, atëherë i është sqaruar kryeprokurorit se në bazë të udhëzimit administrativ 12/2012 neni 6 “te gjitha kafshët duhet të jenë të shenjzuar me shenja në vesh”, ju sqaroj se furnizimi me numra tek veterinarët bëhet me nga dy matrikuj me të njëjtin numër që kafshëve duhet të ju vendosen në të dy veshët, duke qenë se kafshët kanë qenë të dyshuar si kontrabandë atëherë është kërkuar nga ana e prokurorit që të verifikohet origjina e kafshëve. Gjatë kontrollimit të kafshëve është evidentuar se me datë 04.06.2021, 12 krerë gjedhe (lopë) nuk përputheshin disa me moshën, disa me gjininë dhe disa me racën, por edhe nga ato që nuk përputheshin me asnjërën nga të lartcekurat pra moshën, gjininë dhe racën, ndërsa duke qenë se nga gjedhet e kontrolluara 17 prej tyre nuk kishin matrikuj në asnjërin vesh mirëpo kishin vrima në vesh nuk ju dëshmoi origjina e tyre për shkak se u mungonin shenjat, vrimat në vesh dëshmonin se kanë pasur të vendosur më herët matrikuj. Nga ana e Doganës së Kosovës atë ditë janë konfiskuar 29 krerë gjedhe nga të lartpërmendurat, pastaj është vazhduar inspektimi me datën 05.06.2021 në zonën e njëjtë, lokacionin e njëjtë ku ishin prezent rreth 30 krerë gjedhe, gjate kontrollimi të tyre ishin dy krerë gjedhe pa matrikuj por me vrima në vesh që nuk vërtetohej origjina e tyre të cilat janë konfiskuar nga Dogana e Kosovës për shkak te mungesës se informacionit të origjinës së tyre. Pastaj përveç gjedheve të moshës madhore janë konfiskuar edhe 3 viqa prej të cilëve 2 kanë qenë me matrikuj dhe 1 pa matrikuj të cilët janë shoqëruar sipas fermerit sepse janë të lindura nga nënat e tyre që janë konfiskuar

dhe duhet të ushqehen me qumësht. Numri i përgjithshëm i gjedheve të konfiskuara ka qenë 32 qkrerë. Tutje dëshmitari deklaroi se në bazë të udhëzimit të lartpërmendur administrativ lindjen e kafshëve duhet ta lajmëroj fermeri dhe jo me vonë se 7 ditë nga lindja e tij tek veterinari i kontraktuar nga A.U.V, gjithashtu edhe humbjen e matrikujve fermeri duhet ta lajmëroj tek autoriteti kompetent në afat prej 7 ditëve nga humbja e tyre, ndërsa autoriteti duhet ta lëshoj në afat prej 28 ditëve nga dita e lajmërimit të tyre, që në rastin konkret as për lindjen e viqave dhe as për humbjen e matrikujve të lartcekur nuk kemi pasur njoftim nga ana e fermerit, ndërsa pas njoftimit nga fermeri për lindjen e një gjedhi të ri autoriteti kompetent ka për obligim që pa kaluar afati prej 20 ditëve ti pajis ato gjedhe me matrikuj. Ndërsa arsyeja pse kam deklaruar në prokurori se brenda 6 muajve lejohet të bëhet matrikulimi i kafshëve të lindura është pasi që ashtu e parasheh udhëzimi administrativ se kryeshefi ekzekutiv mund ta bëjë një amnisti- përjashtim që ky matrikulim të bëhet brenda gjashtë muajve. Në bazë të udhëzimit administrativ të lartpërmendur çdo kafshë duhet të pajiset me shenjë identifikimi- matrikuj, duhet të këtë pasaportën e saj edhe tek shitblerja e tyre tek këto gjedhe nuk ndryshon shenja identifikuese dhe pasaporta e saj edhe pse në pasaportë shënon edhe pronari i atij gjedhi mirëpo në të është edhe një rubrikë e veçantë ku mund të shënohet blerësi i tyre e cila mbushet nga veterinari në momentin e kalimit të atij gjedhi nga një pronar tek tjetri, mirëpo gjithmonë lëvizja e kafshëve duhet të bëhet me pasaportë. Ju njoftoj se verifikimin e gjedheve prezentë në këtë rast me urdhër të prokurorit është kërkuar që të bëhet verifikimi i gjedheve të moshës mbi 6 muaj.

2.3 Deklarata e dëshmitarit S.S.:

Dëshmitari S.S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: më kujtohet se për këtë rast unë kam dhënë një deklaratë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, me datë 04.06.2021 është kërkuar nga ana e Policisë së Kosovës përkatësisht nga Stacioni Policor në Ferizaj që të bëhet inspektimi i disa gjedheve të cilat janë të vendosura në zonën e ish aeroportit bujqësor- KFOR-i grek në G., arsyeja ka qenë sepse ka pasur dyshim se janë të kontrabanduara, në momentin e inspektimit nga ana jonë në vendin ku kanë qenë të vendosura gjedhet të rrethuara në një zonë të caktuar ish-in prezent rreth 80 krerë gjedhe, duke qenë se arsyeja e kontrollës ka qenë me urdhër të prokurorisë dhe policisë atëherë në koordinim me kryeprokurorin Shukri Jashari është kërkuar që të bëhet kontrollimi i gjendjes shëndetësore të tyre dhe verifikimi i origjinës së tyre sipas mandatit të A.U.V, duke qenë se A.U.V, është autoritet që merret me gjendjen shëndetësore të kafshëve dhe posedon bazën e të dhënave për identifikimin dhe regjistrimin e

kafshëve brenda territorit të Kosovës, i është bërë kontrollimi i kafshëve prezentë. Gjate kontrollës apo verifikimit të gjedheve të moshave të ndryshme sepse nga ana e prokurorit është kërkuar nga unë që të jepet një koment për çështjen e matrikulimit të kafshëve dhe periudhën se kur duhet të kryhet ky shërbim tek fermerët, atëherë i është sqaruar kryeprokurorit se në bazë të udhëzimit administrativ 12/2012 neni 6 “të gjitha kafshët duhet të jenë të shenjëzuara me shenja në vesh”, ju sqaroj se furnizimi me numra tek veterinarë bëhet me nga dy matrikuj me të njëjtin numër që kafshëve duhet te ju vendosen në të dy veshët, duke qenë se kafshët kane qenë të dyshuar si kontrabandë atëherë është kërkuar nga ana e prokurorit që të verifikohet origjina e kafshëve. Gjatë kontrollimit të kafshëve është evidentuar se me datën 04.06.2021, 12 krerë gjedhe (lopë) nuk përputheshin disa me moshën, disa me gjininë dhe disa me racën, por edhe nga ato që nuk përputheshin me asnjërën nga te lartcekurat pra moshën, gjininë dhe racën, ndërsa duke qenë se nga gjedhet e kontrolluara 17 prej tyre nuk kishin matrikuj në asnjërin vesh mirëpo kishin vrima në vesh nuk ju dëshmoi origjina e tyre për shkak se u mungonin shenjat, vrimat në vesh dëshmonin se kanë pasur të vendosur me herët matrikuj. Nga ana e Doganës së Kosovës atë ditë janë konfiskuar 29 krerë gjedhe për shkak se nga të lartpërmendurat, pastaj është vazhduar inspektimi me datën 05.06.2021 në zonën e njëjtë, lokacionin e njëjtë ku ishin prezent rreth 30 krerë gjedhe, gjatë kontrollimit të tyre ishin dy krerë gjedhe pa matrikuj por me vrima në vesh që nuk vërtetohej origjina e tyre të cilat janë konfiskuar nga Dogana e Kosovës për shkak të mungesës së informacionit të origjinës së tyre. Pastaj përveç gjedheve të moshës madhore janë konfiskuar edhe 3 viqa prej të cilëve 2 kanë qenë me matrikuj dhe 1 pa matrikuj të cilët janë shoqëruar sipas fermerit sepse janë të lindura nga nënat e tyre që janë konfiskuar dhe duhet të ushqehen me qumësht. Numri i përgjithshëm i gjedheve të konfiskuara ka qenë 32 krerë. Në bazë të udhëzimit të lartpërmendur administrativ lindjen e kafshëve duhet ta lajmëroj fermeri dhe jo me vonë se 7 ditë nga lindja e tij tek veterinari i kontraktuar nga A.U.V, gjithashtu edhe humbjen e matrikujve fermeri duhet ta lajmëroj tek autoriteti kompetent në afat prej 7 ditëve nga humbja e tyre, ndërsa autoriteti duhet ta lëshoj në afat prej 28 ditëve nga dita e lajmërimit të tyre, që ne rastin konkret as për lindjen e viqave dhe as për humbjen e matrikujve të lartcekur nuk kemi pasur njoftim nga ana e fermerit, ndërsa pas njoftimit nga fermeri për lindjen e një gjedhi të ri autoriteti kompetent ka për obligim që pa kaluar afati prej 20 ditëve ti pajis ato gjedhe me matrikuj. Ndërsa arsyeja pse kam deklaruar në prokurori se brenda 6 muajve lejohet të bëhet matrikulimi i kafshëve të lindura është pasi që ashtu e parasheh udhëzimi administrativ se krye shefi ekzekutiv mund ta bëjë një amnisti- përjashtim që ky matrikulim të bëhet brenda gjashtë muajve. Në bazë të udhëzimit administrativ të lartpërmendur çdo kafshë duhet të pajiset me shenjë identifikimi-

matrikuj, duhet të këtë pasaportën e saj edhe tek shitblerja e tyre tek këto gjedhe nuk ndryshon shenja identifikuese dhe pasaporta e saj edhe pse në pasaportë shënon edhe pronari i atij gjedhi mirëpo në të është edhe një rubrikë e veçantë ku mund të shënohet blerësi i tyre e cila mbushet nga veterinari në momentin e kalimit të atij gjedhi nga një pronar tek tjetri, mirëpo gjithmonë lëvizja e kafshëve duhet të behët me pasaportë. Në bazën e të dhënave të A.U.V me datë 06.06.2021, pasi është bërë verifikimi nga ne, në sistemin ku i përcjellim këto të dhëna lidhur me fermerin dhe gjedhet e tij ka figuruar se tek ky fermer nuk ka qenë e regjistruar asnjë lopë e moshave madhore në fermën e cila është në pronësi të tij. B.U. është inspektor veterinar në A.U.V që punon në regjionin e Pejës dhe me kërkesën time në rastin konkret i njëjti pasi janë dërguar këto gjedhe në Dubravë ka shkuar dhe ka bërë verifikimin e këtyre gjedheve sa i përket gjendjes shëndetësore të tyre dhe ka bërë marrjen e mostrave të tyre për analiza dhe i njëjti ka përpiluar procesverbal për këtë dhe gjendjen shëndetësore të tyre të cilin e kemi dorëzuar në këtë rast me dokumentet tjera.

2.4 Deklarata e dëshmitarit K.R.:

Dëshmitari K.R. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Më kujtohet se për këtë rast kam dhënë një deklaratë në prokurori, unë këtë profesion e ushtroj nga viti 2003 dhe e njoh Z.R. pasi që i njëjti nga ajo kohë ka pasur fermë me dele dhe kemi bashkëpunuar me të njëjtin sa i përket ofrimit të shërbimeve veterinare, pasi që jam veterinar i licencuar nga A.U.V, unë obligimet e mia ligjore në këtë rast sa i përket kësaj ferme i kam kryer dhe gjithashtu për këtë fermë unë kam ofruar edhe shërbime tjera private. Z.R. viteve të fundit dhe atë përafërsisht që 2 apo 3 vite ka filluar që biznesin e tij si fermerë ta zgjeroj edhe sa i përket gjedheve tjera pasi që në fillim ka punuar me një numër të deleve si dhe një numër të vogël të gjedheve, unë i kam ofruar shërbime profesionale si veterinar lidhur me këtë që ka të bëjë mbikëqyrjen e këtyre gjedheve dhe matrikulimin e tyre pasi që është obligim ligjor si dhe shërbime të tjera lidhur me shëndetin e këtyre gjedheve për të cilat nuk kemi të lidhur ndonjë marrëveshje të veçantë mirëpo me kërkesën e fermerit ne e kryejmë këtë shërbim. Në rastin konkret unë kam bërë matrikulimin vetëm të viqave deri në gjashtë muaj të cilët më herët nuk kanë qenë të matrikuluar dhe nuk kanë pasur vrima në veshët e tyre, ndërsa gjedhet tjera nuk i kemi matrikuluar pasi që nuk na lejohet me ligj në rast se kanë mbi 6 muaj, por atyre u lejohet vetëm ri- matrikulimi nga numri paraprak në rast të humbjeve e që në rastin konkret nuk e kemi bërë pasi që kjo bëhet me kërkesë dhe dëshmi të ofruar nga pronari e cila nuk është bërë në rastin konkret. Në rastin e shitblerjes së gjedheve ka raste kur përpilohet marrëveshje me shkrim për

shitjen e tyre që me sa më kujtohet edhe tek fermeri për te cilin po flasim mund të këtë dokumente sa i përket shitblerjes së gjedheve ndërsa momenti kur bëhet shitje e tyre dhe ndërrohet pronari nga veterinari kompetent që është për atë fermë në bazë të pasaportës që posedon ai gjedh e cila është obligative që ta këtë çdo kafshë, bëhet ndërrimi i pronarit me po atë pasaporte ku në anën e majtë janë të dhënat e pronarit aktual ndërsa në anën e djathtë shënohen të dhënat e pronarit të ri apo të blerësit të gjedhit e cila është kolonë që mbushet nga veterinari kur ndryshon pronari i gjedhit. Në rastin konkret me kërkesën e fermerit dhe atë rreth 7 ose 8 ditë para konfiskimit unë me ekipin tim kemi shkuar për të bërë matrikulimin e kafshëve deri në 6 muaj mirëpo për shkak se kanë qenë në një hapësirë të hapur nuk kemi mundur ti përfundojmë të gjitha, nuk më kujtohet nëse kemi pasur ri- matrikulim tek këto gjedhe edhe pse ka pasur edhe nga ato mbi 6 muaj, më kujtohet se shumica nga ato kanë pasur matrikula por jo të gjitha dhe nuk e kam pyetur se pse të njëjtat nuk kanë matrikula pasi që nuk është obligim i joni, regjistrimi i tyre në sistemin që e ceka më lartë varet nga numri i gjedheve të cilat kanë për tu regjistruar dhe nga koha që ato marrin mirëpo bazuar në dispozitat ligjore nga momenti i regjistrimit të tyre në terren deri në momentin e regjistrimit të tyre në sistem kemi hapësirë kohore nga 7 deri në 10 ditë. Matrikulat përmbajnë vetëm numër të cilat vendosen në veshët e kafshëve ndërsa data e vlefshmërisë së tyre është nga momenti kur hynë në sistem të A.U.V-it.

2.5 Deklarata e dëshmitarit B.U.:

Dëshmitari B.U. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Në vend ngjarje në fshatin ... kanë dal inspektorët e AVU, dega në Ferizaj, unë nuk kam dale në vend të ngjarjes, unë e ushtroj detyrën e inspektorit në Zyrën Regjionale në Pejë. Ku në këtë zyre janë pranuar kafshët Burgu i Dubravës i cili e njofton autoritetin kompetent me dalë në vend të ngjarjes për rastin në fjalë. AUV duke e pasur për detyrë dhe përgjegjësi mes shërbimit korrektues dhe veterinar ku nga gjaku i kafshëve e nxjerrin veterinarët të kontraktuar nga Ministria e Drejtësisë ndërsa ne e mbikëqyrim procesin e drejtpërdrejtë ku në rastin konkret procesin e drejtpërdrejtë e kam përcjell unë personalisht, ku gjatë gjithë procesit kam mbajtur shënime dhe të dhënat konkrete ku më pastaj i kam dërguar përmes procesverbalit janë njoftuar Burgu i Dubravës si dhe Dogana e Kosovës, ku në ato shënime vërtetohet qartë se të gjitha kafshët kanë rezultuar negativ me sëmundjen “Bruceloza” ndërsa tridhjetë e dy krerë (32) kanë qenë tërësisht të shëndosha, por për dy vjeta (viqave) nuk jam në dijeni se a u është bërë testi, ne nuk e kemi për detyrë që të merremi me pronësinë e kafshëve, por dua të shtoj se kemi vërejtur se disa prej

tyre konkretisht 15 copë posedonin disa shenja identifikuese ndërsa të tjerat jo, ambulanta veterinare ka te drejtë të vendos përkohësisht disa numra provizor ku këto janë përdorur në këtë rast konkret. Në raste konkrete dokumentacioni që pala posedon në vend të ngjarjes të cilat na e prezantojnë ne i dërgojmë Burgut të Dubraves por në rastin konkret neve nuk na është prezantuar asgjë pasi që të njëjtit nuk kanë pranuar ndonjë dokument nga pala, veç se kemi identifikuar se disa kanë qenë të racës si mental ndërsa disa të tjera të racës bushe, ku sipas moshës kanë qenë rreth dy- tre muaj, si dhe prej moshës 4 vjeçare deri në moshën 10 vite.

2.6 Deklarata e dëshmitarit B.A.:

Dëshmitari B.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Unë punoj në Doganën e Kosovës nga viti 2001 dhe aktualisht jam udhëheqës i Drejtorisë Rajonale të Gjilanit ndërsa në vitin 2021 kam qenë udhëheqës i Zyrës së Brendshme Doganore në Ferizaj, dhe e di se për cilin rast jam duke dëshmuar sot. Procedura e doganës fillon kur policia na njofton për ndonjë rast të kontrabandimit të mallrave dhe detyra e doganës është ti administroj ato kafshë deri në vendin e autorizuar për mbajtje, në këtë rast me sa me kujtohet ka qenë burgu i Dubravës, me këtë dogana e përfundon procedurën ndërsa policia dhe AVUK-u. Përmes telefonit jam njoftuar nga shefi i pikës së H.i.E. N.Q. dhe pastaj e kam autorizuar shefin e ndërrimit Sh.S. që të dal në vendin e ngjarjes që të jetë prezent së bashku me policinë dhe AVUK-un dhe i njëjti ka dal në vendin e ngjarjes ndërsa nuk ka bërë raport sepse këtë e bënë policia, ku ne njoftohemi dhe e kemi obligim që mallin e kontrabanduar ta strehojmë në depo ose në burgun e Dubravës, Sh.S. më ka njoftuar përmes telefonit se rasti është proceduar dhe ka shkuar në Dubravë. I njëjti më ka njoftuar se policia i ka marr lopët dhe i ka dërguar në Dubravë pasi dyshohet se janë të kontrabanduara dhe me rastin e dërgimit të mallit gjegjësisht në këtë rast të kafshëve në këtë rast ka përfunduar detyra jone dhe nuk kemi pasur kurrfarë përgjegjësie.

2.7 Deklarata e dëshmitarit I.R.1.:

Dëshmitari I.R.1. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Unë e njoh Z.R. që 5-6 vite, i njëjti merret me kafshë gjegjësisht me dele, ku njëherë i kemi ndërruar disa krerë lopë me dele, ku unë ja kam dhënë 8 lopë ndërsa i kam marre 100 dele, kjo ka ndodhur në janar-shkurt në vitin 2021 diku. Unë këto lopë i kam blerë nëpër tregje të ndryshme të kafshëve. Unë merrem herë pas herë me blerjen dhe shitjen e kafshëve, kafsha duhet ti këtë të ngjitur vathët, ndërsa disa prej tyre lopëve kanë pasur vathë e disa nuk kanë pas por nuk më kujtohet mirë sepse rasti ka ndodhur që 3 vite. Vathët duhet me i pas në të dy veshët me sa e di unë, ndërsa

në këtë rast nuk më kujtohet se a i kanë pasur vathët në të dy veshët, unë kur i kam ble dhe kur i kam shitur këto lopë nuk kam pasur asnjë dokument dhe nuk kanë qenë të regjistruara në emrin tim edhe pse të njëjtat i kam blerë në Kosovë, siç deklarova i kemi shitur dhe i kemi blerë pa dokumente, unë tani kam dele dhe të njëjtat i kam me dokumente, nga Z.R. nuk kam marrë dokument ndërsa tani i kam të regjistruara 64 dele nuk e di a janë dele prej këtyre 100 që i kam marr nga Z.R. por këto i kam regjistruar ka ardhur mjeku dhe janë me dokumente të rregullta dhe këto dokumente i kam diku në shtëpi. Pasi që të arrin moshën prej 12 muaj e llogarisim dele, ndërsa pasi i kam blerë këto 100 dele nuk kam shkuar për ti regjistruar, ndërsa a është dashur të shkoj të i regjistroj nuk e di. Nga 8 lopët që ja kam dhënë Z.R. 4-5 prej tyre kanë qenë të mbarësuar ndërsa 3-4 tjera kanë qenë me viqa të vegjël të cilët i kanë pasur nga 2-3 muaj, nuk më kujtohet a ka qenë një apo dy me ngjyrë të zezë ndërsa shumica kanë qenë të kuqe si dhe me lara bardhë dhe kuq, Z.R. e kam takuar edhe pas vitit 2021 pasi e shoh në tregje të kafshëve dhe kam dëgjuar se Z.R. ja kanë marrë lopët ndërsa i njëjti nuk më ka thënë asnjëherë se ja kanë marre lopët që i ka ndërruar me mua, pasi që kemi bërë pazar unë kam qenë tek ferma e Z.R. dhe ja kam ndërtuar një ahur- stallë ndërsa nuk i kam pa lopët që ja kam dhënë sepse në atë moment ka pasur edhe lopë tjera dhe nuk e di a kanë qenë ato. Ditën që kam shkuar tek ferma e Z.R. ai nuk më ka thënë asgjë lidhur me lopët që i ka ndërruar me mua.

2.8 Deklarata e dëshmitarit I.R.2.:

Dëshmitari I.R.2. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Me Z.R. njihemi nga viti 2021 pasi që më të njëjtin e kam bërë një pazar ku unë i kam dhënë 30 krerë lope ndërsa ai mi ka dhënë 200 krerë dele, me sa më kujtohet ka qenë muaji mars i vitit 2021. Unë e kam parë Z.R. që në vitin 2021 ka blerë lopë qumështore në tregje dhe atë në tregun e Ferizaj dhe të Lipjanit, ku në Lipjan i ka blerë 2 copa ndërsa në Ferizaj me sa më kujtohet i ka blerë 3 copa, nuk më kujtohet saktë muaji a ka qenë shkurt apo mars por e di se Z.R. i ka blerë 14 lopë prej një personi por nuk e di se kush është dhe nga është por e njoh si figurë në treg dhe më kujtohet se atë ditë Z.R. ka kërkuar që të ja bart lopët me kombi, por unë nuk kisha mundësi sepse i kisha të ngarkuara dy lopë të miat. Lopët të cilat ja kam dhënë Z.R. janë lopë të blera që i kam blerë nëpër tregje të Kosovës dhe të njëjtat kanë qenë të përziera të kuqe, të zeza, lloj lloj dhe nuk më kujtohet se a kanë pasur vathë në vesh ndoshta ndonjë ka pasur. E di që duhet me i pas vathët në vesh por edhe tani në treg ka plot kafshë pa vathë, këto 30 krerë nuk i kam pasur me dokument në emrin tim dhe as nuk kam mundur të i regjistroj me dokument në emër të Z.R., po ashtu as për dele nuk kam marrë kurrfarë dokumenti dhe pas kësaj ngjarje prapë jam takuar me Z.R. dhe më ka thënë se pse nuk i kanë vathët dhe unë i kam thënë se kështu i kam blerë dhe

kështu ti kam shit si dhe ju kanë rënë vathët, ndërsa nuk e kam pas obligim që të shkoj dhe të njoftoj Agjencionin e Veterinarisë, ndërsa që ja kanë marr lopët Z.R. e kam marrë vesh në telefon në rrjetin social “Facebook”, ku aty i kam parë edhe disa prej lopëve që ja kam dhënë unë, por edhe Z.R. më ka thënë personalisht se ja kanë marr disa nga lopët që ja kam dhënë unë ndërsa numri nuk më kujtohet sepse kjo ngjarje ka ndodhur në vitin 2021, pasi që këto lopë i ka marrë për të hap një qumështore.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari Z.R. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: konsideroj se në këtë rast më është bërë një pa drejtësi, sepse të gjitha këto kafshë janë blerë brenda territorit të Kosovës, kjo çështje është sqaruar edhe nga dëshmitarët por edhe nga faktet e çështjes, në vitin 2019 – 2020, unë i kam blerë këto kafshë me qëllim që ta hapi një qumështore edhe vet dëshmitari K.R. kur ka ardhur me i trajtuar kafshët për ndonjë sëmundje e ka vërejtur se ka qenë një sasi e madhe e lopëve edhe para kësaj kohe, një vit me parë dhe këto lopë i kemi kullotur në fshatin ... në vjeshtën e vitit 2020, dhe kur janë ndaluar për kullotje livadhet me datë 06.05.2021, dhe tek vendi i quajtur Milenium ku përpara kanë qëndruar KFORI G., aty me datë 07.05.2021 i kemi dërguar lopët mi kullot dhe aty i kemi mbajtur deri me datë 04.06.2021, sepse aty është vendi i hapur dhe sikur të kishin qenë këto kafshë të kontrabanduara nuk do ti kisha mbajtur në një vend aq të hapur dhe publik pasi kanë qenë skaj rrugës. Unë para datës 05.06.2021, pesë ditë apo një javë përpara e kam vërejtur një veture “Golf” i cili çdo mbrëmje na ka përcjellë nga vendi rruga e “B.” deri i kemi mbyllur kafshët, por unë nuk e kam pasur asnjë shqetësim sepse kam qenë gjithçka në rregull dhe këto kafshë i kam blerë në tregun e Kosovës, sepse po mos të kisha diçka në rregull do ti kisha marr lopët dhe do te isha shkuar në bjeshkët. Data nuk më kujtohet saktë por e di që fillimi i muajit të gjashtë, unë kam qenë në bjeshkë duke rregulluar stanin për dele dhe rrethojat për dele dhe kanë thirrur barinjte dhe kanë thënë se kanë ardhur policia tek bagëtitë dhe unë kam ardhur prej bjeshkës për brenda 40 minuta dhe policia kishte qenë ende aty dhe mua mi kërkuar dokumentet e lopëve dhe unë ju thash nuk i kam të gjitha këtu por do të mundohem ti siguroj, dhe ata kanë filluar verifikimin e matrikulave dhe aty me është bërë një padrejtësi dhe me sa kam unë njohuri vetëm fermeri mund ta përcaktoj moshën e kafshës pasi që nuk mundet një inspektor me thanë që një kafshë është katër vjeçare kurse matrikula është 3 vjeçare dhe të njëjtit i kam thënë se si ki mundësi me verifikuar një gjë të tillë dhe më ka thënë se si ti shikoj në kry e di, dhe më ka thënë se në matrikull po shënon simentall, ndërsa lopa qenka krejt e

kuqe, nuk i përket racës simentalle dhe unë i kam thënë se ka racë edhe të kuqe simentall edhe kuq e bardh dhe me këto konsideroj se më është bërë pa drejtësi dhe kam parë që çfarëdo që të flasësh është e kotë dhe ai shënojke siç ja merrte mendja e vet, pastaj kanë ardhur i kanë ngarkuar dhe i kanë marr 32 krerë, ndërsa kanë mbetur rreth 80 dhe unë ju kam thënë merri edhe viqat e vegjël sepse do të ngordhin pasi ja keni marr nënat që i kanë dhe ata më kanë thënë se nuk kemi të drejtë mi marr viqat dhe unë i kam lutur që ti marrin por nuk i kanë marrur dhe pastaj i kanë marr dy viqa të vegjël dhe asnjëherë nuk më është kthyer asnjëri prej këtyre kafshëve dhe dua të shtoj se transportimi i këtyre kafshëve nuk ka qenë human sepse i kanë ngarkuar me një furgon të mbyllur dhe i kanë lanë 4-5 orë të ngarkuara në temperaturë mbi 34 gradë, dhe lopët kanë filluar me bërtit brenda në furgon dhe unë i kam thënë hapni se po ngordhin prej nxehtësisë dhe ai më ka thënë se ky nuk është problemi yt, ky është problem jonë dhe unë për këtë çështje edhe e kam lajmëruar rastin në polici, sa i përket matrikulave dua të shtoj se edhe ekspertet e kanë konstatuar se deri në 20 % matrikulat dëmtohen apo humbin. Unë biznesin si fermer e kam të regjistruar që kur ka filluar të bëhet regjistrimi i bizneseve të kafshëve, diku mbi 10 – 15 vite dhe këto lopë i kam blerë në Kosovë në shumicën e rasteve në Ferizaj dhe Lipjan, në fshatin T. dhe B. Në fillim kur kam filluar me blerë, nuk e kam ditur se për lopë duhet me pas dokumentacion për me marr prej atij shitësit, por më vonë jemi informuar dhe kemi filluar me marr herë pas here dokumentacionin, por jo të gjitha sepse nuk kemi arritur me kontaktuar me shitësit dhe kur i kam blerë lopët një pjesë kanë pasur matrikula ndërsa një pjesë nuk kanë pasur. Gjatë periudhës së vitit 2019-2021, kanë ardhur veterinarët kur ka pasur nevojë në fermën time, ndërsa ai kanë kontrolluar këto kafshët që i kanë konfiskuar unë nuk e di sepse në Kosovë jam kohë pas kohe pasi jetoj në Gjermani. Në fshatin ..., Republika e Maqedonisë së Veriut, nuk kam qenë asnjëherë dhe nuk e njoh askënd nga ky vend. Ndërsa në Maqedoninë e Veriut kam qenë pasi kam familjar dhe kam punëtor në Gjermani që janë të punësuar tek unë dhe kanë prejardhjen nga fshatrat e Shkupit dhe Tetovës.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka

nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç ‘rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit L.R. dhe nga e njëjta gjeti se në bazë të udhëzimit administrativ 12/2012 neni 6 “te gjitha kafshët duhet të jenë të shenjzuar me shenja në vesh”, ju sqaroi se furnizimi me numra tek veterinarët bëhet me nga dy matrikuj me të njëjtin numër që kafshëve duhet të ju vendosen në të dy veshët. Gjatë kontrollimit të kafshëve është evidentuar se me datë 04.06.2021, 12 krerë gjedhe (lopë) nuk përputheshin disa me moshën, disa me gjininë dhe disa me racën, por edhe nga ato që nuk përputheshin me asnjërën nga të lartcekurat pra moshën, gjininë dhe racën, ndërsa duke qenë se nga gjedhet e kontrolluara 17 prej tyre nuk kishin matrikuj në asnjërin vesh mirëpo kishin vrima në vesh nuk ju dëshmoi origjina e tyre për shkak se u mungonin shenjat, vrimat në vesh dëshmonin se kanë pasur të vendosur më herët matrikuj. Nga ana e Doganës së Kosovës atë ditë janë konfiskuar 29 krerë gjedhe nga të lartpërmendurat, pastaj është vazhduar inspektimi me datën 05.06.2021 në zonën e njëjtë, lokacionin e njëjtë ku ishin prezent rreth 30 krerë gjedhe, gjatë kontrollimit të tyre ishin dy krerë gjedhe pa matrikuj por me vrima në vesh që nuk vërtetohej origjina e tyre të cilat janë konfiskuar nga Dogana e Kosovës për shkak të mungesës së informacionit të origjinës së tyre.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit S.S. dhe nga e njëjta gjeti se në bazë të udhëzimit administrativ 12/2012 neni 6 “te gjitha kafshët duhet të jenë të shenjzuara me shenja në vesh”, dhe se furnizimi me numra tek veterinarët bëhet me nga dy matrikuj me të njëjtin numër që kafshëve duhet të ju vendosen në të dy veshët, duke qenë se kafshët kanë qenë të dyshuar si kontrabandë atëherë është kërkuar nga ana e prokurorit që të verifikohet origjina e kafshëve. Gjatë kontrollimit të kafshëve është evidentuar se me datën 04.06.2021, 12 krerë gjedhe (lopë) nuk përputheshin disa me moshën, disa me gjininë dhe disa me racën, por edhe nga ato që nuk përputheshin me asnjërën nga të lartcekurat pra moshën, gjininë dhe racën, ndërsa duke qenë se nga gjedhet e kontrolluara 17 prej tyre nuk kishin matrikuj në asnjërin vesh mirëpo kishin vrima në vesh nuk ju dëshmoi origjina e tyre për shkak se u mungonin shenjat, vrimat në vesh dëshmonin se kanë pasur të vendosur më herët matrikuj.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit K.R. dhe nga e njëjta gjeti se i njëjti e ka bërë matrikulimin vetëm të viqave deri në gjashtë muaj të cilët më herët nuk kanë qenë të matrikuluar dhe nuk kanë pasur vrima në veshët e tyre, ndërsa gjedhet tjera nuk i ka matrikuluar pasi që nuk iu lejohet me ligj në rast se kanë mbi 6 muaj, por atyre u lejohet vetëm ri- matrikulimi nga numri paraprak në rast të humbjeve e që në rastin konkret nuk e ka bërë pasi që kjo bëhet me kërkesë dhe dëshmi të ofruar nga pronari e cila nuk është bërë në rastin konkret.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit B.U. dhe nga e njëjta gjykata gjeti se të gjitha kafshët kanë rezultuar negativ me sëmundjen “Bruceloza” ndërsa tridhjetë e dy krerë (32) kanë qenë tërësisht të shëndosha dhe se dëshmitari ka vërejtur se disa prej tyre konkretisht 15 krerë posedonin disa shenja identifikuese ndërsa të tjerat jo.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit B.A. mirëpo e njëjta nuk kishte ndonjë vlerë provuese sa i përket kësaj çështjeje penale pasi që i njëjti vetëm ka përshkruar procedurën e bartjes së lopëve nga momenti i konfiskimit e deri te dërgimi i tyre në Burgun e Dubravës

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së dëshmitarit I.R.1. dhe nga e njëjta gjeti se: i njëjti ia ka dhënë 8 lopë të pandehurit ndërsa i ka marrë 100 dele, kjo ka ndodhur në janar-shkurt në vitin 2021 diku dhe këto lopë i ka blerë nëpër tregje të ndryshme të kafshëve, i kemi shitur dhe i kemi blerë pa dokumente, mirëpo i njëjti nuk ka mundur të identifikoj nëse lopët që i janë konfiskuar të pandehurit janë lopët të cilat ia ka shitur të pandehurit.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së dëshmitarit I.R.2. nga e cila gjeti se i njëjti ia ka dhënë 30 krerë lopë të pandehurit ndërsa i pandehuri ia ka dhënë 200 krerë dele dhe se i njëjti e ka parë të pandehurin që në vitin 2021 ka blerë lopë qumështore në tregje dhe atë në tregun e Ferizaj dhe të Lipjanit, dhe se këto 30 krerë nuk i ka pasur me dokument në emrin e tij dhe as nuk ka mundur të i regjistroj me dokument në emër të pandehurit, mirëpo i njëjti nuk ka mundur të identifikoj nëse lopët që i janë konfiskuar të pandehurit janë lopët të cilat ia ka shitur të pandehurit.

Nga Kërkesa për rishikim e çështjes së gjedheve drejtuar Agjensionit të veterinarisë me datë 09.06.2021, gjykata gjeti se i pandehuri i është drejtuar Agjensionit të Veterinarisë së Kosovës

ku i ka theksuar pretendimet e tij se lopët e konfiskuara nuk janë të kontrabanduara por të blera në tregjet e Kosovës.

Nga pasaportat e gjedhit gjykata gjeti se 10 prej tyre ishin në emër të A.S. nga Vushtria kurse 9 të tjera ishin në emër të I.R.2. nga Kaçaniku.

Nga procesverbali me numër 001095 i datës 03.08.2018 gjykata gjeti se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka bërë kontrolle në fermën e deleve në fshatin ..., komuna e Kaçanikut dhe këtë inspektim e kanë bërë me kërkesë të policisë.

Nga lista e kafshëve sipas fermës e datës 16.06.2021 gjykata gjeti se është përpiluar lista me 73 gjedhe ku janë të përshkruar numrat e identitetit, gjinia, data e lindjes, mosha, raca dhe data e regjistrimit.

Nga Mendimi për përcaktimin e vlerës të lëshuar nga Dogana e Kosovës e datës 07.06.2021 gjykata gjeti se vlera e mallit është 9,374 euro.

Nga Raporti mbi ekspektimin e kafshëve me numër të referencës AUV04-... i datës 07.06.2021 gjykata gjeti janë konfiskuar 35 krerë kafshë – gjedhe të cilat kanë gjendje shëndetësore të mirë, pa shenja klinike të ndonjë sëmundje infektive, pa temperaturë dhe pa lëndime fizike trupore.

Nga deklarata e dëshmitarit F.B. e dhënë në polici me datë 05.06.2021 gjykata gjeti se i njëjti punon tek i pandehuri dhe se i njëjti vetëm ka theksuar se i pandehuri ka rreth 70 krerë lopë dhe se asnjëherë asnjë inspektor nuk ka ardhur për t'i kontrolluar kafshët.

Nga Procesverbali me numër ... i datës 04.06.2021 gjykata gjeti se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka bërë kontrolle në zonën shtegtare të gjedheve në fshatin ... në Ferizaj dhe këtë inspektim e kanë bërë me kërkesë të policisë.

Nga Procesverbali me numër ... i datës 05.06.2021 gjykata gjeti se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka bërë kontrolle në zonën shtegtare të gjedheve në fshatin në Ferizaj dhe këtë inspektim e kanë bërë me kërkesë të policisë.

Nga Shkresa me titull dorëzimi i kafshëve të gjalla e datës 05.06.2021 gjykata gjeti se me datë 05.06.2021 Policia e Kosovës i ka dorëzuar Doganës së Kosovës krerë gjedhe të gjalla (3 lopë) me peshë 1320 kg të kontrabanduara të cilat do të dërgohen në Burgun e Dubravës përmes kontraktorit të Doganës N.N. “Zh.”.

Nga Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 05.06.2021 gjykata gjeti se tek i pandehuri Z.R. janë sekuestruar 3 krerë lopë me peshë 1320 kilogram.

Nga Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 04.06.2021 gjykata gjeti se tek i pandehuri Z.R. janë sekuestruar 29 gjedhe të mëdha (femra) dhe 3 viça.

Në 16 fletë të formatit A4 me fotografi janë të paraqitura kafshët e sekuestruara.

5.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Në kohë të pa caktuar e gjer me datë 05.06.2021 në fshatin ..., Komuna Ferizaj saktësisht në një shteg të improvizuar dhe të rrethuar përkohësisht me qëndrim të lirë, i pandehuri duke kaluar vijën kufitare Republikë e Maqedonisë Veriore - Republikë të Kosovës përmes rrugëve malore bartë mallra - gjedhe të gjalla dhe shmang kontrollin doganor, në atë mënyrë që i pandehuri nga fshati ..., Republika e Maqedonisë Veriore, përmes rrugëve malore ka bartë tridhjetë e pesë (35) copë gjedhe të gjalla prej të cilave trembëdhjetë (13) prej tyre kishin nga një numër identifikues vetëm në njërin veshë e që nuk përputhën me të dhënat në sistemin e AUV-it, ndërsa njëzet e dy (22) tjera pa pasur fare dokumentacion dhe në mungesë të verifikimit të origjinës së tyre të gjitha gjedhet sekuestrohen nga Policia e Kosovës.

Neni 311 paragrafi 1 KPRK-së përcakton se: “*Kushdo që duke kaluar vijën kufitare bartë mallra dhe shmang kontrollin doganor, ose kushdo që duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallrave dhe kalon vijën kufitare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet*”. Kjo veprë penale kryhet me dy veprime kumulative ashtu që duke iu shmangë kontrollit doganor e kalon vijën kufitare. Veprimet e kryerjes janë shmangia nga kontrolli doganor dhe kalimi i vijës kufitare në rastin konkret i pandehuri duke kaluar vijën kufitare Republikë e Maqedonisë Veriore - Republikë të Kosovës përmes rrugëve malore bartë mallra - gjedhe të gjalla dhe shmang kontrollin doganor. Mallrat të cilat i nënshtrohen Doganës

konsiderohen të gjitha sendet të cilat e kalojnë zonën doganore, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Mallra doganore konsiderohen edhe kafshët.

Për më tepër me rastin e kontrollimit të matrikulave janë gjetur 12 raste kur kafshët kanë pasur matrikula por të dhënat në matrikula nuk i përshtaten kafshës që e mbanë atë matrikulë dhe atë sa i përket moshës, racës dhe gjinisë si në vijim:

- ..., nuk përputhet mosha dhe gjinia
- ..., nuk përputhet gjinia;
- ..., nuk përputhet mosha;
- ..., nuk përputhet raca;
- ..., nuk përputhet mosha dhe gjinia;
- ..., nuk përputhet mosha dhe gjinia;
- ..., nuk përputhet raca;
- ..., nuk përputhet mosha;
- ..., nuk përputhet raca;
- ..., nuk përputhet mosha;
- ..., nuk përputhet mosha dhe gjinia;
- ..., nuk përputhet raca dhe gjinia;

Andaj, me të drejtë shtrohet pyetja se pse këto kafshë kanë matrikula që nuk i përshtaten moshës, gjinisë dhe racës së caktuar dhe nëse të njëjtat nuk janë të kontrabanduara cili do të ishte qëllimi që këtyre kafshëve tu vendoseshin matrikulat që nuk janë të tyre. Po ashtu sikur këto kafshë të ishin nga Republika e Kosovës që prej periudhës pas 6 (gjashtë) muajve pas lindjes do ti vendoseshin matrikulat dhe do ti krijohej pasaporta e gjedhit. Andaj, nuk qëndron as arsytimi i të pandehurit se këtyre kafshëve iu kanë rënë matrikulat sepse edhe sikur t’iu kishin rënë matrikulat për të njëjtat do të duhej të ishte pasaporta (që i pandehuri nuk ka pasur pasaportë të gjedhit), e aq më tepër edhe sikur t’iu kishin rënë matrikulat është detyrim i të pandehurit që t’i lajmëronte organet kompetente për humbjen e matrikulave dhe tu vendoseshin matrikula të reja (e që i pandehuri nuk e ka bërë), e për më tepër kur i pandehuri e ka një përvojë të gjatë në veprimtarinë e tij me biznesin e kafshëve.

I pandehuri i ka propozuar dy dëshmitar prej të cilëve ka pretenduar se i ka blerë (ndrruar) këta gjedhë, mirëpo dëshmitarët I.1.dhe I.R.2. pasi janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor asnjëri nuk ka

dëshmuar se krerët e lopëve të cilat i kanë ndërruar (shitur-blerë) me të pandehurin kanë qenë pikërisht lopët të cilët edhe janë konfiskuar.

Andaj nga të gjitha të lartcekurat gjykata vërtetoi përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Z.R., ka kryer veprën penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dy mijë) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë në 4 (katër) këste nga 500 (pesëqind) euro brenda afatit prej 4 (katër) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, kurse rrethanë rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit për kryerjen e veprës penale.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi për konfiskim

Neni 311 paragrafi 6 i KPRK-së përcakton se: *“Mallrat nga paragrafi 1., 2. ose 3 i këtij neni konfiskohen. Nëse mallrat nuk mund të gjinden ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të konfiskohen, paguhet ekuivalenti i shumës së mallrave”*. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata sa i përket konfiskimit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8.Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mblledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij program”*. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko - civil.

9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2021:127025, me datë 23.04.2024

Zyrtarja ligjor,

Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.